

## A.2 NDRYSHORET

Ndryshoret janë pjesë e përkufizimeve të raporteve, që përcaktojnë tekstin në raport (p.sh. në dokument, statistika...). Përdoruesit e ndryshoreve mund të përcaktojnë vlerat sipas dëshirës së tyre.

Ndryshoret që i përgatit IZUM-i janë të ruajtura në grupin përkufizimet standarde në modulën COBISS3/Raportet. Nëse dëshironi të ndryshoni vlerën e ndryshoreve të caktuara, përkufizimet e këtyre ndryshoreve i kopjoni në grupin e përkufizimeve të përdoruesit dhe atje i redaktoni.

Për redaktimin e përkufizimeve të ndryshoreve ju nevojiten autorizimi *RPT\_VAR* – mirëmbajtja e ndryshoreve dhe klasifikimi.

### A.2.1 Përkufizimet standarde

Në tabelën A.2-1 ndodhen ndryshoret për koleksionet e bibliotekës, të përkufizuara në modulën COBISS3/Raportet. Në kolonën e parë shfaqet emri i ndryshores, në të dytën vlera e saj, në të tretën raportet, në të cilat ndryshorja respektohet.

**Tabela A.2-1: Ndryshoret për modulën COBISS3/Koleksionet e bibliotekës**

Emri	Vlera	Përdorimi
1) <b>Raporti i pranimit – LLOJI_I_RRESHTIT</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
2) <b>Raporti i pranimit – SHENJA_VEND</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
3) <b>Raporti i pranimit – VPR_ID</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
4) <b>Raporti i pranimit – VPOS_ID</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
5) <b>Raporti i pranimit – KODI_ARTIKULLI</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
6) <b>Raporti i pranimit – GRUPI_AMORTIZUES_MATERIALET_BAZË</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
7) <b>Raporti i pranimit – GRUPI_AMORTIZUES_INVENTARI_I_IMIT</b>		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit

8) Raporti i pranimit – LLOJI_COA		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
9) Raporti i pranimit – KONTO_MATERIAL_I_BAZË		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
10) Raporti i pranimit – KONTO_INVENTARI_I_IMËT		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
11) Raporti i pranimit – GJENDJA_OS		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
12) Raporti i pranimit – PËRMIRËSIMI_VLE_RAT		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
13) Raporti i pranimit – PËRMIRËSIMI_VLE_RAT_1		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit
14) Raporti i pranimit – KONSTANT_PRIOR_IN		Eksporti i të dhënave në formatin MFERAC – raporti i pranimit

## A.2.2 Përkufizimet e përdoruesit

Vlerat e reja ndryshoreve u përcaktohen në modulin COBISS3/Raportet. Moduli është i disponueshëm nga shfletuesi përmes zgjedhjes **Raportet / Moduli Raportet**.

Nëse dëshironi që ndryshores t'i përcaktoni vlerën e re që duhet të respektohet në raport, përkufizimin e asaj ndryshoreje që ndodhet në grupin *përkufizimet standarde* e kopjoni në grupin *përkufizimet e përdoruesit* dhe atje e redaktoni.

### Procedura

1. Në nëndritaren **Grupet e përkufizimeve** hapet dosja **Ndryshoret / Përkufizimet standarde / MFerac**.  
Në nëndritaren e djathtë shfaqet lista e përkufizimeve të grupit të përzgjedhur.
2. Në listën e përkufizimeve të ndryshoreve përzgjidhni ndryshoren, të cilës dëshironi t'i përcaktoni vlerën e re.
3. Përzgjidhni metodën **Redaktimi / Kopjo**
4. Në nëndritaren **Grupet e përkufizimeve** hapni dosjen **Ndryshoret / Përkufizimet e përdoruesit / MFerac**, në të cilën do të ruani përkufizimin e përdoruesit (nëse dosja **MFerac** nuk ekziston atë e krijoni duke përzgjedhur dosjen **Përkufizimet e përdoruesit** dhe metodën **Grupi / E re**).
5. Përzgjidhni metodën **Redaktimi / Ngjit**.

6. Në nëndritaren **Përkufizimet e grupeve të përzgjedhura** në listën e përkufizimeve të ndryshoreve përzgjidhni përkufizimin e ndryshores, të cilës dëshironi t'i përcaktoni vlerën.
7. Përzgjidhni metodën **Përkufizimi / Karakteristikat**.  
Hapet dritarja **Përkufizimi i ndryshoreve**.
8. Ndryshoni të dhënat. Tek "Emri" mund të ndryshoni emrin e ndryshores, ndërsa tek "Vlera" vlerën e saj.
9. Të dhënat ruani.